



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-102
Prishtinë, më 28 prill 2010, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 28 PRILL 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Petar Miletiq, Xhezair Murati dhe Numan Baliq;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga ICO: Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 prill 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 13 maj 2010,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 prill 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 prill 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 13 maj 2010

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme të Kuvendit të mbahet më 13 maj 2010, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës e paluajtshme,
4. Debat për gjendjen në Ndërmarrjet Publike Qendrore, sipas mocionit të deputetit, Driton Tali, mbështetur edhe nga njëmbëdhjetë deputetë të tjerë.

Rendi i ditës për seancën plenare më 13 maj 2010, ndërkohë mund të plotësohet edhe me pika të tjera, të cilat i plotësojnë kushtet për procedim.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Mocionit të deputetit Driton Tali për debat parlamentar rreth gjendjes në ndërmarrjet publike qendrore

Kryesia vendoi që Mocioni i deputetit Driton Tali të radhitet për shqyrtim në seancë plenare më 13 maj 2010.

3.2 Shqyrtimi i Marrëveshjes për kredi dhe grand ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit të IDA-s

Kryesia lidhur me këtë pikë nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë Propozim-Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Raporti i MEF-it për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2009

Kryesia lidhur me këtë pikë nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që ta shqyrtojë Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2009, dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale

Kryesia vendosi që kërkesën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale ta procedojë në seancë plenare.

3.5 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s për delegacionin e Kuvendit, për pjesëmarrje në seminarin e 74-të ROSE – ROTH, që mbahet në Finlandë nga 17-19 qershor 2010

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pjesëmarrja e tre deputetëve të Kuvendit në Seminarin e 74-të Rose Roth, të organizuar nga Asambleja Parlamentare NATO-s, në Helsinki, Finlandë prej 16-20 qershor 2010.
2. Përbërja e delegacionit prej tre anëtarësh (pozita, opozita dhe komunitetet) caktohet nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në bashkëpunim me Kryetarin e Kuvendit.
3. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe mëditjet për të lartpërmendurit në paragrafin 1 të këtij vendimi, i mbulon organizatori – OSBE-ja.

3.6 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të Kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, z. Haki Shatri, në Finlandë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Haki Shatrit, dhe i zyrtares së Komisionit, Fatime Qorri, për të marrë pjesë në Seminarin mbi komisionet për mbikëqyrjen e financave publike, në Helsinki, Finlandë, prej 16 – 19 maj 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

3.7 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e vizitës zyrtare të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, z. Gani Koci, në Mal të Zi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci dhe i sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi, në Beçiç – Budvë, Mali i Zi, prej 3 - 7 maj 2010.
2. Shpenzimet e qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i mbulon Institutit Demokratik Kombëtar (NDI), ndërsa transporti dhe pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit, nr. 02-V-096.

Kryesia, gjithashtu, u njoftua lidhur me Raportin e Trustit për Kursime Pensionale të Kosovës, për tremujorin e parë të këtij viti, si dhe me Informatën e deputetes Nerxhivane Dauti lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Turqi.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale